



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 maj 2021
Nr. ref.:RK1787/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI63/20

Parashtrues

Ilir Zymberi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit
Ac. nr. 4336/19 të 6 shkurtit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ilir Zymberi, (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës) nga fshati Molliq, komuna e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 4336/19 të 6 shkurtit 2020, si dhe Aktvendimin PPP. nr. 2/19 të Gjykatës Themelore të 11 korrikut 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat, pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 prill 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
7. Më 4 qershor 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Përmes të njëjtit njoftim, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që të plotësojë formularin zyrtar të kërkesës, të dorëzojë në Gjykatë Aktvendimin PPP. nr. 2/19 të Gjykatës Themelore të 11 korrikut 2019, si dhe informatat në lidhje me kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
8. Më 17 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës, Njoftimin (KMLC nr. 56/20 të 10 qershorit 2020) të Gjykatës Supreme në lidhje me kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë, megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk e dorëzoi Aktvendimin PPP. nr. 2/19 të Gjykatës Themelore të 11 korrikut 2019.
9. Më 12 prill 2021, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 20 dhjetor 2018, Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejme KEK) kundër parashtresit të kërkesës parashtroi propozim për ekzekutim për shkak të borxheve të papaguara për energji elektrike të konsumuar për periudhën prej 5 shkurtit 2011 deri më 20 mars 2013. Të njëjtën ditë, përmbaruesi privat G.D. lejoi ekzekutimin përmes urdhrit P. nr. 1379/18.
11. Më 26 dhjetor 2018, parashtresi i kërkesës parashtroi kundërshtim ndaj urdhrit për përmbarim (P. nr. 1379/18) në Gjykatën Themelore në Gjakovë, duke deklaruar se borxhi i kontestuar ishte parashkruar.
12. Më 11 korrik 2019, Gjykata Themelore në Gjakovë, me Aktvendimin [PPP. nr. 2/19] refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e debitorit ekzekutiv, duke arsyetuar se parashtresi i kërkesës e pranoi borxhin ndaj KEK-ut duke lidhur një marrëveshje për pagesën e borxhit (nr. 61422) të 12 prillit 2018 me KEK-un.
13. Në një datë të pacaktuar, ndaj Aktvendimit [PPP. nr. 2/19] të Gjykatës Themelore në Gjakovë, parashtresi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të, *“shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
14. Më 6 shkurt 2020, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin [Ac. nr. 4336/19], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtresit të kërkesës dhe vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Themelore, me arsyetimin se *“në rastin konkret palët ndërgjyqëse në mes tyre kanë lidhur Kontratën për pagesën e borxhit Nr. 61422 e datës 12.04.2018 si dhe Deklaratën mbi dakordimin e borxhit Nr. 61422 e datës 12.04.2018, me të cilën palët janë pajtuar që borxhin ta paguaj përmes ri programimit të borxhit prej 870.08 Euro, me qëllim që të përfitoj sipas Ligjit Nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike dhe ti falet shuma prej 2.070.90 Euro, të cilën kontratë nuk ka përmbushur debitori, pasi që ka qenë i obliguar që borxhin e dakorduar ta paguaj në 18 këste, i njëjti ka paguar vetëm një këst në bazë të nenit 3 të kontratës 61307 të datës 25.01.2018, ku ceket se „në rast se përfituesi shkakton 3 vonesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas programimit, marrëveshja shkëputet dhe pjesa e paguar e borxhit, nëse ka, fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet“, borxhi i paguar është fshirë, ndërsa pjesa e mbetur e borxhit i është rikthyer, e pasi që përpos marrëveshjes së lidhur po ashtu edhe pagesat e bëra nga ana e debitorit ndërpresin afatin e parashkrimit në kuptim të dispozitës së lartcekur, andaj qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë mbi refuzimin e prapësimit të debitorit është i drejtë dhe i ligjshëm, ndërsa pretendimet ankimore të debitorit lidhur me parashkrimin e borxhit rezultojnë si të pathemelta të cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi që ta vërtetojë”*.
15. Në një ditë të pacaktuar, parashtresi i kërkesës ndaj aktvendimeve të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, parashtroi propozim Prokurorit të Shtetit për të iniciuar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

16. Më 10 qershor 2020, Prokurori i Shtetit me Njoftimin KMLC nr. 56/2020 njoftoi parashtruesin e kërkesës se „*propozimi nuk u aprovua, sepse në këtë çështje nuk ka një bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë*”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, pa specifikuar se si ka ardhur deri te ato shkelje.
18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se „*Gjykata e shkallës së parë, ka refuzuar kundërshtimet e debitorit duke konsideruar se shkaqet e cekura në prapësimin e debitorit nuk bëjnë pjesë në shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së, për çka konsiderojmë që ajo gjykatë gabimisht ka vendosur në mënyrë të tillë, për faktin se janë dhënë arsye të mjaftueshme me të cilat është provuar se Ekstraki nga librat afarist të kreditorit është akt i njëanshëm i kreditorit, i pabazuar në ligj dhe se nuk përbën titull përmbarimor*”.
19. Parashtruesi i kërkesës shton se „*Sa i përket kontratës së nënshkruar mes palëve, përkatësisht kreditorit dhe debitorit lidhur me riprogramimin e borxhit, duhet pasur parasysh që kemi të bëjmë me një kontratë me të drejta dhe detyrime dypalëshe, ashtu që në këtë rast nuk mund që kreditori të kërkoj pagesën e borxhit duke u thirrur në atë kontratë nëse te njëjtën nuk e respekton*”.
20. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, „*Nëse palët nuk respektojnë kontratën, atëherë mbetet gjendja ashtu siç ka qenë para lidhje se saj dhe e njëjta nuk krijon efekt juridik, dhe në këtë rast kreditori nuk mund të kërkojë borxh më të vjetër se deri në janarin e viti 2017*”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

23. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

24. Sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në cilësi të palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4336/19] të 6 shkurtit 2020, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
25. Megjithatë, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kërkesën e pranueshmërisë të përcaktuar në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

26. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në bazë të dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e

njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

27. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi të pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”*, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; Pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284).
28. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
29. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon që përmes vendimeve të kontestuarra është shkelur neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
30. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përsërit të njëjtat argumente që ai i kishte paraqitur në procedurat pranë Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, se gjykatat e rregullta janë marrë me këtë çështje, kështu që në paragrafët vijues Gjykata do të shtjellojë më tej procedurat në gjykatat e rregullta.
31. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së reduktohen në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimin dhe interpretimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta, dhe me këtë ai ngrit çështjen e aplikimit dhe interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata që *të vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve të kontestuarra*, gjë që bie ekskluzivisht në juridiksionin e gjykatave të rregullta (ligjshmëria).
32. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se vërtetimi i plotë gjendjes faktike, si dhe interpretimi dhe zbatimi i ligjit janë brenda juridiksionit të plotë të gjykatave të

rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e “*shkallës së katërt*” (Shih: në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 56; dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 58).

33. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih në këtë kontekst dhe, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, Parashtrues: *Limak Kosovo International Airport J.S.C.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, Parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, Parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
34. Gjykata gjithashtu thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (Shih: në këtë drejtim, GJEDNJ *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës KI128/19, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, para. 42).
35. Në këtë drejtim, për t’i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtrueseve të kërkesës, duhet pasur parasysh se “*drejtësia*” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “*substancial*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës (Shih: në këtë drejtim, rastin e Gjykatës KI64/20, parashtrues: *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41 dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
36. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga ana e gjykatave të rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, në këtë kontekst rastin e GJEDNJ-së, *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI128/19, cituar më lart, paragrafi 59).

37. Në fund, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve të lartpërmendura pa argumentuar ose arsyetuar shkeljen e tyre me vendimet e kontestuara.
38. Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore, sipas të cilës vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës K102/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafi 36; dhe K195/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafi 34).
39. Një qëndrim i tillë i Gjykatës është i bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, pretendimet apo ankesat e paarsyetuara dhe të pambështetura me argumente e prova, shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; Pjesa I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283). Përveç kësaj, pretendime të tilla, e të cilat nuk qartësojnë shkeljet e pretenduara në mënyrë adekuate, janë gjithashtu të papranueshme bazuar në nenin 48 të Ligjit në lidhje më pikën d) të paragrafit 1 të rregullit 39 të Rregullores së punës, mbi bazën e të cilave parashtruesit e kërkesave kanë për detyrë që kërkesat e tyre t'i qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate t'i paraqesin faktet dhe pretendimet përkitazi me të drejtat dhe liritë themelore të cilat pretendohet se u janë cenuar.
40. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk sqaroi qartë faktet dhe pretendimet për shkelje të neneve të sipërpërmendura të Kushtetutës dhe për rrjedhojë, këto pretendime duhet të shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.
41. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 12 prill 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi